



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2245/2 prot

Datë 18.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77404-08-14-2023 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*”, me fond limit 10,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF, me NUIS L61608005C dhe adresë: Rruga Muhamet Veliu, Pallati ILIAD, Shkalla 1, kati 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz
Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT K91624505A , me adresë: Fshati Ahemtaq, prane firmes Ital Kon, Prezë, Tiranë

Në datën 14.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2245/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3413 e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77404-08-14-2023 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*”, me fond limit 10,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK, të parashruara në ankesën me nr. 2245 prot.

Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, të kriterëve si më poshtë vijon:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.4.2 Operatori ekonomik në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt e kërkuar në shtojcen 6, përkatësisht me nr.rendor **1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12**. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si, adresën e saktë të subjektit që e ka lëshuar këtë dokument, telefoni/e-mail/ëebsite, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK-së në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga një moster fizike për artikujt e kërkuar në shtojcen 6, përkatësisht me nr.rendor **1** deri në **12, 14, 21, 22, 29, 41, 42, 43, 44, 45**. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim. Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DT.

2.4.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet e testimit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcen 6, përkatësisht me nr.rendor **1** deri **12**, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 18.09.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri